REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr./Br. 935/20
Datum. 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.935/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Luboteni-A"SH.P.K.-Shtërpcë, kundër njoftimi mbi vendimin e AK-së (njoftimit për dhënie të kontratës), ku është rekomanduar për kontratë grupi OE "Euro-Infrastruktura:Ejup Shabani B.I"-Hani i Elezit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rritja e kapacitetit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Jazhnicë" me nr. të prokurimit: 655-20-6103-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK-Shtërpcë", më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **<u>REFUZOHET</u>**, si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Luboteni-A"SH.P.K,-Shtërpcë, kundër njoftimi mbi vendimin e AK-së , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rritja e kapacitetit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Jazhnicë" me nr. të prokurimit: 655-20-6103-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK-Shtërpcë".

II. **<u>VËRTETOHET</u>**, njoftimi mbi vendimin e AK-së, vendim për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rritja e kapacitetit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Jazhnicë" me nr. të prokurimit: 655-20-6103-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK-Shtërpcë".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: "Luboteni-A"SH.P.K,-Shtërpcë, i refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Luboteni-A" SH.P.K.-Shtërpcë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 13.11.2020 me nr. 935/20, kundër njoftimi mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rritja e kapacitetit të rrjetit të ujësjellësit në fshatin Jazhnicë" me nr. të prokurimit: 655-20-6103-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK-Shtërpcë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 27, 28, 52, 59, 69, 72 dhe neni 108/A të LPP-së, si dhe Pika 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK-Komuna Shtërpce lidhur me pajisjen 7. Makinë për shpim horizontal nëntokësor me sistem laser të kontrollit prej DN 250--DN 1400 më së paku 1 (një). Eksperti i OSHP-se sqaron se OE ankues nuk e plotëson kriterin e kërkuar si ne FDT dhe NJK, dhe ne rast se ka pasur paqartësi ne kritere OE ka qene dashtë te beje ankese ne kritere deri me dt. 13.10.2020 për sqarime, kurse kërkesa për rishqyrtim ka mund te behet 5 dite para hapjes se ofertës sipas paragrafit 2.3.1 te nenit 108/A thuhet: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave; Pra, AK e ka precizuar qartë ne dosjen e tenderit, por ne rastin konkret OE ankues nuk e ka shfrytëzuar afatin dhe te drejtën ligjore për ankese. Pra, OE i rekomanduar e disponon pajisjen e kërkuar sipas kritereve te FDT dhe NJPK. Edhe ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK thotë se: OE ankues nuk e ka shfrytëzuar ankesën për kritere para hapjes se ofertave siç ka qene afati ligjor.

Pra, siç pretendon OE ankues, se AK ka shkelur nenin 1,6 te LPP-së, sqaroje se AK duhet te vlerësoj sipas kërkesave te vendosura ne FDT dhe NJPK, konkretisht sipas paragrafit 4 te nenit 59 te LPP-së, Pretendimi ankimor i OE ankues i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të ankesat të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet ne fuqi vendimi i AK-se, sepse OE i rekomanduar e plotëson pajisjen e kërkuar sipas pikës 9.1 & 9.2 te FDT-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 24.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 25.11.2020 , me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, "Luboteni-A"SH.P.K- Shtërpcë, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Përshëndetje, ne me datë 24.11.2020,kemi pranuara raportin e ekspertizës nga eksperti shqyrtues lidhur me ankesën 935/20. Eksperti shqyrtues shihet qartë se nuk ka shqyrtuar pretendimet tona, dhe vërehet asi qare qe ka shqyrtuar vetëm një pretendim me dy rreshta, dhe të njëanshëm. Kompania "Luboteni-A"SH.P.K, nuk pajtohet me raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues Luboteni-A"SH.P.K.-Shtërpcë, se AK-Komuna Shtërpce lidhur me pajisjen 7. Makinë për shpim horizontal nëntokësor me sistem laser të kontrollit prej DN 250--DN 1400 më së paku 1 (një). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues nuk e plotëson kriterin e kërkuar si në FDT dhe njoftimin për kontratë, si dhe në rast se ka pasur paqartësi në kritere OE ka qenë dashtë të bëjë ankesë në kritere deri me dt. 13.10.2020 për sqarime. Kurse, kërkesa për rishqyrtim ka mund të behet 5 ditë para hapjes së ofertës sipas paragrafit 2.3.1 të nenit 108/A thuhet: në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Pra, AK e ka precizuar qartë në dosjen e tenderit por në rastin konkret OE ankues nuk e ka shfrytëzuar afatin dhe të drejtën ligjore për ankesë. OE i rekomanduar e disponon pajisjen e kërkuar sipas kritereve të FDT dhe njoftimit për kontratë. Edhe në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim, AK thotë se:

OE ankues nuk e ka shfrytëzuar ankesën për kritere para hapjes së ofertave siç ka qenë afati ligjor.
Pra, siç pretendon OE ankues se AK ka shkelur nenin 1,6 të LPP-së, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK duhet të vlerësoj sipas kërkesave të vendosura në FDT dhe njoftimin për kontratë, konkretisht sipas paragrafit 4 të nenit 59 të LPP-së. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se OE ankues nuk e plotëson kriterin e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me pajisjen 7, kurse OE i rekomanduar e posedon kërë pajisje. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se autoriteit kontraktues ka bërë vlerësimin ofertave në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Shtërpcë";

1x1 OE "Luboteni-A" SH.P.K,Shtërpcë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.